



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:135921
Datë: 20.02.2024
Numri i dokumentit: 05347555

C.A.P.nr.1338/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Besnik Bislimaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Sh. Z., të cilin me autorizim e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat me seli në lagjen Ulpiana C-2, 2/6, në Prishtinë, kundër debitorit SHSKUK-QKUK, me seli në Prishtinë, për përmbartimin e dokumentit përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1742/2020, të datës 14.04.2023, më datë 20.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Sh. Z., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1742/2020, të datës 14.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.1742/2020, të datës 14.04.2023, ka vendosur si në vijim: APROVOHET i bazuar prapësimi i debitorit SHSKUK-QKUK në Prishtinë, ashtu që ANULOHET urdhri përmbartimor lejuar nga Përmbartuesi privat Afet Mjeku, P.nr.1217/20, i datës 28.05.2020, dhe REFUZOHET i pabazuar propozimi për përmbartim i parashtruar nga kreditori Sh. Z.”.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, kreditori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën e kreditorit dhe ta prish aktvendimin e ankimuar ashtu që të lihet në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.1217/20, i datës 28.05.2020. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se debitori të ketë parashtruar përgjigje në ankese.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Sh. Z., me datë 28.05.2020, përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur propozim për përmbartim pranë përmbartuesit privat Afet Mjeku, për lejimin e përmbartimit në bazë të titullit ekzekutiv, vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, vendimit Nr. 303/2020, të datës 19.05.2020 si dhe Vendimit nr.303/2020, të datës 19.05.2020. Përmbartuesi Privat Afet Mjeku, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, me Urdhrin P.nr.1217/20, të datës 28.05.2020 e ka caktuar përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, me datë 08.06.2020, ka ushtruar prapësim përmes së cilit e ka kundërshtuar propozimin për përmbartim për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me arsyetim se propozimi për përmbartim është iniciuar me anë të aktit administrativ i cili nuk është bërë i ekzekutueshëm ngase ndaj të njëjtit është e lejuar e drejta e paraqitjes së ankesës e për të cilat arsye ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar ndërsa urdhri për lejimin e përmbartimit të anulohet ashtu që propozimi për përmbartim të hedhet poshtë si i bazë.

Me përgjigje në prapësim kreditori i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura me anë të prapësimit si të pabazuara duke theksuar se debitori nuk ka paraqitur asnjë dëshmi lidhur me përmbushjen e obligimit të tij siç nuk ka paraqitur asnjë provë lidhur me pretendimet e paraqitura në prapësim, prandaj ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr.1217/20, i datës 28.05.2020 të vërtetohet si dhe të detyrohet debitori që kreditorit t'ia paguaje shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit, me aktvendimin e atakuar, ka vendosur që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se një dokument përmbartimor për të shërbyer si titull përmbartues patjetër duhet të përmbaj element e përcaktuara me dispozita ligjore dhe se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë komulative dhe mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Në këtë rast përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe e ka cilësuar si titull përmbartues Vendimin e Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, vendim i lëshuar në procedurë administrative, mirëpo vendimi i tillë nuk mund të konsiderohet titull përmbartues ngase në dispozitiv nuk e përmban shumën e detyrimit, nuk përmban periudhën kohore dhe nuk përmban afatin brenda të cilës duhet të përmbushet detyrim,

ashtu siç është përcaktuar me dispozitën ligjore të sipërcituar. Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 22, paragrafi 1, nën paragrafi 2, neni 23, paragrafi 2, neni 27, paragrafi 1, dhe 36 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP).

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditorës, Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbartimor, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbartim, konform dispozitave ligjore në fuqi. Andaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret dokumenti përmbartimor është i papërshtatshëm për përmbartime edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbartimor është i përshatshëm për përmbartim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbartimor – Vendimi i Inspektoratit të Punës nr.01 Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020, i njëjti në dispozitiv nuk e përmban shumën dhe kohën e përmbushjes së detyrimit, e që nuk dihet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qëndrojnë pretendimet prapësuese të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbartueshmërisë së dokumentit përmbartimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, andaj për Gjykatën e Apelit gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e palës kreditore se në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur vendimin korrigjues Nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020 i cili është nxjerrë më pas, mirëpo sipas kësaj gjykate janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për shkak se me shikim në shkresat e lëndës vërtetohet se me rastin e parashtrimit dhe lejimit të propozimit për përmbartim i njëjti është lejuar në bazë të vendimit nr.01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, i cili nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i rregullt përmbartues dhe fakti se është bërë korrigjimi i këtij vendimi nuk ndikon në ndryshimin e vendimit ngase procedura përmbartimore është filluar dhe përmbartimi është lejuar në bazë të dokumentit përmbartimor që është Vendimi i Inspektoratit të Punës nr.01 Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020. Duke i vlerësuar të gjitha pretendimet, gjykata ka vlerësuar se pala kreditore as gjatë procedurës e as me ankesë nuk ka propozuar plotësimin e propozimit përmbartimor, por vetëm pas lejimit të përmbartimit në bazë të dokumentit përmbartues fillestar, ka bashkangjitur

korrigjimin e atij vendimi, andaj dhe gjykata e shkallës së parë sipas prapësimit së debitorit ka qenë e detyruar që të veprojë konform dispozitave ligjore dhe me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, pasi që korrigjimi i vendimit Nr.01/21-1178, i datës 18.11.2020, nuk ka qenë pjesë e propozimin për përmbarim. Eventualisht pala kreditore mund të parashtojë propozim të ri në bazë të vendimit i cili i plotëson kushtet për tu konsideruar dokument i rregullt përmbarimor.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike, sepse gjykata përmbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi, përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *“në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.1338/2023, më datë 20.02.2024

Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v